



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 33 , datë 01/07/2004

**“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN,  
FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE KOMPETENCAT  
E ADMINISTRATËS SË DREJTORISË NR.3  
TË PUNËTORËVE TË QYTETIT”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2004 ‘Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore’ , neni 32, gërma “ç” si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.15, dt.10/03/2004 “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit”, pasi shqyrtoi relacionin e përparuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I;**

1. Të miratojë Rregulloren “Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit për detajimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**